



SHKOLLA E MESME E MUZIKËS

HALIT KASAPOLLI



SOLIDAR
SWITZERLAND
Swiss Labour Assistance SLA

2017



Syri i Vizionit

Ky publikim u mundësua në kuadër të projektit ProKarriera, të cilin organizata joqeveritare “Syri i vizionit” është duke e implementuar me mbështetjen financiare të Solidar Suisse. Projekti ka për qëllim fuqizimin e shërbimit të këshillimit në karrierë nëpër shkolla për të ndihmuar të rinjtë të përshtaten sa më mirë me tregun e punës.

SHKOLLA SOT:

Shkolla e mesme e muzikës është shkollë që mbledh nxënësit e orientuar drejt artit të muzikës, pjesa më e madhe e të cilëve vijnë nga një shkollim i mëparshëm muzikor në shkollën e ultë të muzikës në të njëjtin institucion.

Në këtë shkollë krijohen mundësitë për formimin muzikor dhe artistik, fillimin e karrierës në muzikë, kurse shkolla krijon mundësi të mira për të gjitha ata që duan të ndjekin studimet e larta për muzikë.

Mësimi zhvillohet vetëm në gjuhën shqipe me nxënës të shkollës së mesme, ndërsa në atë të ultë edhe në gjuhën boshnjake. Në Shkollën e Muzikës ndjekin mësimin edhe nxënës nga komuna tjera të rajonit të Pejës, pasi në komunat tjera të rajonit nuk ka shkolla muzikore dhe kjo është e vetmja mundësi. Në këtë shkollë nuk është i mundur edhe shkollimi për të rritur, pa shkëputje nga puna (me korrespondencë).



DREJTIMET:



Momentalisht në Shkollën e muzikës mësohet në dy profile: i përgjithshëm dhe artistik (instrumental). Profili i parë i referohet shkollimit për bashkëpunëtor të përgjithshëm muzikor, kurse në profilin e dytë, sipas llojit të instrumentit në të cilën është përqendruar nxënësi, janë gjashtë profile: Piano, Violinë, Flaut, Kitarë, Klarinetë dhe Trombon.

HISTORIK:



Shkolla e mesme e muzikës “Halit Kasapolli” është shkolla e mesme e fundit që është hapur në Pejë. Ajo ka filluar punë në dekadën e kaluar, edhe pse si shkollë e ulët e muzikës ka ekzistuar në Pejë për dyzet vjet, që nga viti 1976 dhe ka përcjellë gjenerata të tërë artistësh dhe muzikantësh, që e kanë marrë këtu bazën e parë. Shkolla e mesme e muzikës është krijuar me bazë nga Shkolla e ulët e muzikës. Nxënësit e parë në shkollën e mesme kanë filluar në vitin shkollor 2008-2009. Nga kjo periudhë e krijimit si shkollë e mesme edhe e ka marrë emrin e mësipërm.

KAPACITETET:

Shkolla është e vendosur në një hapësirë të pamjaftueshme prej 230 metra katrorë në katin e parë të Shtëpisë së Kulturës në Pejë. Në këtë hapësirë janë të vendosura 9 klasa, 1 sallë koncertesh dhe dy zyra.

Në vitin shkollor 2016/2017 në shkollën e mesme janë të regjistruar 61 nxënës, kurse në shkollën e ulët të muzikës janë 211 nxënës. Për shkak të specifikës me punën individuale dhe hapësirës dhe stafit që ka shkolla, klasat kanë një numër jo të madh nxënësish, me nga një paralele në secilin profil profesional. Shkolla ka një sasi të kufizuar mjetesh dhe instrumentesh muzikore, që mundësojnë zhvillimin mësimi, ndërsa ka nevojë për blerje dhe riparime të vazhdueshme, ndërsa nxënësit duhet të kenë instrumentet e tyre individuale.

Komuna e Pejës është në proces të ndërtimit të objektit të ri të Shkollës së Muzikës, një proces që pritet të përfundojë në një afat të shkurt dhe do t'i dhurojë Pejës një shkollë të re shumë të nevojshme me dy kate, hapësirë të mjaftueshme dhe dy salla koncertale.



PJESËMARRJA NË PROJEKTE

Për shkak të specifikës që ka shkolla, nxënësit e saj janë të përfshirë në aktivitete të ndryshme muzikore dhe artistike që ndodhin në qytetin e Pejës dhe jashtë tij, duke përfshirë edhe pjesë të paraqitjeve të nxënësve në kuadër të realizimit të planprogramit mësimor, por edhe në paraqitje jashtë shkollore.

Shkolla ka marrë pjesë në gara ndërkombëtare për piano në Itali dhe ka marrë shpërblime në drejtim për piano, në Kroaci, ndërsa në aktivitete tjera lokale ka një paraqitje të mirë të nxënësve dhe grupeve të shkollës, qoftë si angazhime individuale, apo paraqitje e përbashkëta.

Posaçërisht Kori i shkollës ka qenë aktiv dhe ka prezantuar me sukses në shumë aktivitete shkollën dhe Pejës në Kosovë dhe jashtë saj.



PSE TË REGJISTROHEM NË KËTË SHKOLLË?

Shkolla e mesme e muzikës paraqet një hallkë me rëndësi në formimin muzikor dhe artistik në qytetin e Pejës. Pavarësisht vështirësive që ka në funksionimin e kësaj shkolle, mes nxënësve ka gjithnjë interesim për shkollën, pasi është e vetmja shkollë e tillë në regionin e Pejës. Përparësi tjetër është se shkolla ka një numër të vogël nxënësish që kanë mundësi shkollimi në këtë institucion dhe mësimi bëhet individual me secilin nxënës. Gjatë shkollimit krijohen mundësi për angazhimin artistik, fillimisht në programet dhe aktivitete në kuadër të shkollës, por edhe më gjerë në aktivitete jashtë shkollore.

Shkolla krijon mundësi për të gjithë ata që duan të ndjekin shkollimin e lartë për muzikë, pasi nga kjo shkollë nxënësit kanë përparësi në regjistrimin në studime universitare për muzikën.

TREGU I PUNËS

Shkollat e mesme të muzikës në Kosovë janë dizajnuar në mënyrë të tillë që në radhë të parë të shërbejnë për edukimin muzikor dhe përgatitjen e nxënësve për shkollimin e mëtejshëm në arsimimin e lartë. Në këtë kuptim nxënësit që përfundojnë këtë shkollë janë në pjesën më të madhe të përcaktuar për shkollim universitar në muzikë, prandaj shkolla paraqet vetëm një hallkë në shkollimin e mëtejshëm. Nxënësit e mirë arrijnë më lehtë të pranohen në shkollim të mëtejshëm pas një shkolle muzikore.

Me shkollimin e mesme për muzikë tregu i punës nuk jep shumë mundësi punësimi. Me shkollimin e përgjithshëm për muzikë mund të krijohen mundësi punësimi në sektorë ku ka nevojë për një nivel jo shumë të lartë të përgatitjes muzikore, duke siguruar që si bashkëpunëtorë muzikorë të angazhohet në media (psh. radio, etj) apo edhe në institucioneve tjera ku duhet një kualifikim i tillë artistik muzikor. Me angazhim individual dhe me aftësi tjera ata edhe mund të gjejnë angazhime edhe në sektorin privat, apo edhe të nisin iniciativa angazhimi e punësimi individual.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Muzikë- Drejtim i përgjithshëm

Përfundimi me sukses i shkollimit për profilet mësimore të lëmisë së Muzikës lejon nxënësve vazhdimin e shkollimit në studimet universitare ose punësimin e tyre në institucionet e ndryshme ku njohuritë dhe aftësitë e tyre muzikore hyjnë në përdorim, p.sh. redaksitë e ndryshme muzikore të mediave, radiove dhe radiove në internet, në bibliotekat e ndryshme etj.

Përfundimi me sukses i shkollimit për të gjitha profilet mësimore të shkollimit të mesëm profesional muzikor, u lejon nxënësve marrjen e diplomës së maturës profesionale, me të drejtë kalimi në shkollimin e lartë universitar. Nxënësit që përfundojnë shkollimin e mesëm profesional muzikor në drejtimin e përgjithshëm muzikor orientohen kryesisht në studimet e muzikës në fushën e lëmit të shkencave muzikore si dhe pedagogjisë së përgjithshme muzikore.

Muzikë Drejtimi artistik (instrumental)

Pas përfundimit me sukses të klasës së XII dhe testit të maturës profesionale, nxënësit kanë një kualifikim profesional me mundësi integrimi në tregun e punës në disa profile ku munden të kontribuojnë me njohuritë e tyre muzikore dhe fitojnë poashtu mundësinë për studimet universitare në fushën e muzikës.

Nxënësit që përfundojnë drejtimin Artistik-interpretues instrumental kanë mundësi që në studimet universitare në fushën e muzikës të zhvillohen më tej në interpretues muzikorë sipas profilit përkatës, në lëmin e shkencave muzikore, si dhe të pedagogjisë muzikore për instrumentet e caktuara.

Lëmi	Profili
Muzikë Drejtim i përgjithshëm	Bashkëpunëtor i përgjithshëm muzikor
Muzikë Drejtimi artistik (instrumental)	Interpretues Piano
	Interpretues Violinë
	Interpretues Flaut
	Interpretues Kitarë
	Interpretues Klarinetë
	Interpretues Trombon

Për më shumë informata lidhur me kriteret dhe afatet e regjistrimit, shikoni konkurset e pranimit të nxënësve në shkolla, ose informohuni direkt në shkollë.



Kontaktet

Adresa e shkollës: Rr. Wesley Clark p.n., Pejë

Drejtori: Driton Mujaj
e-mail: dritojmujaj@hotmail.com
tel. 044/ 884721